



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS  
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Data 21.08.2024

### PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje drurë shkurre dekorative.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Dru - 03410000-7

Shkurret-03451300-9

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 58.333.333 (pesëdhjetë e tetëmilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë **Monedha, pa TVSH.**

Vlera e fondit Limit në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 585.440,91 (pesëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e katërqind e dyzet presje nntwdhjetw e njw) euro. Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 21.08.2024 është 99.64 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vlerën 1.166.666,66 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë dhe monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 21.08.2024 është 11.708,81 (njëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e tetë presje tetëdhjetë e një) euro.*

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes të Shqipërisë datë 21.08.2024 është 99.64 lek.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.2** - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme u përcaktua që në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO **9001-2015**, pasi kjo është një kërkesë që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohet kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi ka lidhje me sigurinë e cilësisë së mallit që do të furnizohet, pra cdonjëri nga anëtarët e bashkimit të shoqërive që merr përsipër të furnizojë në një përqindje të caktuar për këtë objekt prokurimi duhet të disponojë certifikatën e cilësisë së mallit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

*" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat mbi kufirin e lartë monetar.*

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*Neni 43*

*Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....,

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

## KREU II

### KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare. Në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në gusht të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është mbi kufirin e lartë monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa vlera e përllogaritur e fondit limit të parashikuar të marrëveshjes kuadër.**

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3(tre) viteve te fundit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomik duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

<sup>1</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe konkretisht jo më të vogël se vlera: **23.333.333 (njëzet e tremilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh ose 234.176,36 (dyqind e tridhjetë e katërmijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e gjashtë) Euro** (Kursi i këmbimit referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë me datë 21.08.2024 është 99.64 lek).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të fondit limit të marrëveshjes kuadër. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Lidhur me vitet për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar furnizimi/et e ngjashme të mëparshme, njësia e prokurimit ka përcaktuar si periudhë kohore 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit sikurse përcaktohet në nenin 40 pika 4, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**2.3.2** Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **25 (njëzet e pesë) punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..
- b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar ku specifikisht përcaktohet:

#### **Neni 40**

#### **Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave**

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet si dhe kohezgjatja e kontratës për një afat 24 muaj. Është marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate i cili do të lëvrohet në mënyrë të vazhdueshme sipas periudhave të mbjelljes ka nevojë ditore për mirëmbajtje dhe shërbime deri në momentin e dorëzimit tek autoriteti kontraktor dhe gjithashtu fakti që operatori ekonomik do të marrë përsipër furnizimin dhe transportin e mallit në objektet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për mbjellje cka konvergjon në nevojën e që operatori ekonomik fitues potencila i kontratës të disponojë fuqi punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit me efikasitet dhe më cilësi. Numri i punonjësve tregon besueshmërinë për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit

ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 25 (njetzet e pesë) punonjës është në përputhje me objektin e kontratës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjësve të specializuar te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, punonjës me profesionet si mëposhtë:

- 3(tre) punonjës Automakinistë. Për këto punonjës duhet të paraqitet leje drejtimi (*e vlefshme*), dëshmi e aftësisë profesionale/patente manovrimi e lëshuar nga “Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” (*e vlefshme*), librezë pune, kontratë pune (*e vlefshme*) dhe dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik te lëshuar nga IQT/ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të (*e vlefshme*).
- 1 (një) punonjës që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, shoqëruar me dokumentacionin diplomë/çertifikate, librezë pune dhe kontratë pune (*e vlefshme*).  
(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës " Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
- 6 (gjashhtë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ” Punime në fidanishte ” që vërtetohen me paraqitjen e çertifikatave/diplomave (*e vlefshme*), te cilat duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “ Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën Shqipërisë” shoqëruar me dokumentacionin librezë pune dhe kontratë pune (*e vlefshme*).

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sa më sipër sipas formatit te meposhtem:

Tab 1

Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se lëshuesi eshte institucion privat)

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe me plotësimin e formatit të deklarates sipas Tab 1.*

*Dokumentacioni provues, për kriterin percaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së*

afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Te dhenat per punonjesit sa me siper te paraqiten edhe

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose".

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

*Kërkesa për 3 (tre) Automakinistë " është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt që do të lëvrohen objekt i kësaj kontrate furnizimi. Furnizimi i drurëve dekorative me permasa relativisht të medha dhe transporti i tyre i cili referuar kërkasave të vendosura në këtë procedurë do të merret përsipër të realizohet nga operatori ekonomik kërkon përdorimin e mjeteve të tipave kamiona dhe kamionçina me vinç për drejtimin e të cilëve duhen punonjës automakinistë të pajisur me leje drejtimi ,çertifikatë të aftësisë profesionale/patentë manovrimi të leshuar nga "Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor".*

Kërkesa në lidhje me 1 (një) punonjës që disponon çertifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" është vendosur në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që kontrata të realizohet brenda kushteve të sigurisë duke mbrojtur jetën e punonjësve.Për sa më lart, punonjesi i cili duhet te jene te çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojne çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte,



vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë furnizimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Në lidhje me kriterin ku kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, 6 (gjashtë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për " Punime në fidanishte " është e lidhur ngushtësisht me natyrën dhe artikujt objekt kontrate si dhe me mënyrën e lëvrimin të mallit i cili do të lëvrohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në periudhat e mbjelljes për një kohezgjatje 24 muaj, mungesa e këtij stafi potencialisht mund të çojë në dështimin e kontratës së furnizimit, ose në rastin më pak të keq do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe furnizimin e mallit me cilësi të dobët. *Numri i stafit në lidhje me këtë kriter është minimal dhe është përcaktuar në raport të ngushtë me natyrën specifike të mallit objekt kontrate.*

Kriteret sa më sipër sigurojnë Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik, aftësitë organizative reputacionin dhe besueshmërinë për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt.

**2.3.4** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik inxhinier pyjesh i cili duhet të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik me kohe të plotë pune dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera me qëllim që të ndjekë procesin e mirëmbajtjes dhe dorëzimit të bimësisë dekorative tek Autoriteti kontraktor. Për inxhinierin e pyjeve duhet të paraqitet dokumentacioni provues, Kontratë pune e vlefshme (përkatëse), diplomë, librezë pune, cv.

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik).*

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

*" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."*

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e drurëve dekorative e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet

të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Inxhinieri i pyjeve do të supervizojë mbikqyre të gjithë procesin e mirembajtjes dhe të transportit të drurëve dekorative deri në vendin ku ato do të mbillen me qëllim sigurimin e cilesise të materialit mbjelles bimor deri në momentin e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor. Kriteri sa më sipër është i lidhur ngushtesisht dhe në proporcion me objektin e prokurimit dhe siguron autoritetin kontraktor se operatori ekonomik fitues potencial i procedurës ka stafin e duhur dhe garanton cilësinë e produktit që kërkohe nga autoriteti kontraktor.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e mbi kufirin e lartë monetar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose".*

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohe që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues të ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) agronom të lartë, të vertetuar me diplomë, kontratë pune (të vlefshme), libreze pune, cv dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."*

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, referuar objektit të prokurimit dhe faktit që operatori ekonomik do furnizojë në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesës së autoritetit kontraktor për një periudhë 24 mujore është konsideruar e nevojshme të përcaktohet ky kriter kualifikues pasi operatori ekonomik duhet të ketë kapacitet të mbikqyre, kontrolloje dhe inspektojë bimët gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës me qëllim furnizimin e mallrave objekt prokurimi sipas standarteve të cilësisë të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*"5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose".*

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

- Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte) me sipërfaqe mbi 5.000 (mijë) m<sup>2</sup>, me kushte optimale të furnizimit me ujë dhe plehërimit për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë: *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: *Kontratë huapërdorje.*

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: *Kontratë qiraje.*

Foto të ambientit të magazinimit të bimëve (fidanishte).

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të mirëmbaje në fidanishte bimët me kushte optimale të furnizimit me ujë, plehërimit për bimët deri në momentin e dorëzimit tek autoriteti kontraktor sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 8), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

*Në nennin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, parshikohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës". Në rastin konkret, duke qenë se objekti dhe natyra e kontratës lidhet me furnizimin e bimesisë në mënyrë të vazhdueshme sipas sezoneve të mbjelljes për një periudhë 24 muaj, është e nevojshme për autoritetin kontraktor që të provohet se operatori ekonomik disponon kushtet për mirëmbajtjen e mallit objekt kontrate gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës fakt ky që bën të domosdoshëm nevojën për disponimin e një ambienti mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte).*

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera per mallrat objekt prokurimi te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) *ose* Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave te furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine te leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 per percaktimin e kriterëve te tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) *ose*
- Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori per furnizimin nga subjekti importues ku duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) qe ne momentin e furnizimit me druret dhe shkurret dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike ) do shoqerohen me “ Çertifikate Fitosanitare “ nga shteti importues , e cila verteton pastertine gjenetike bimes .

**Argumentimi:** *Kriteri sa më sipër është vendosur ne perputhje me nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku citohet: “dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje kerkese minimale, per nje dokument cilesie per materialet qe autoriteti kontraktor, kerkon te bleje. Persa me siper kerkohet nje dokument certifikues i cilesise, pra ne perputhje me nenin 77, ligji nr.162, date 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike te kërkuar, qe kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas zerave te preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi jane lehtesisht te sigurueshme, me kosto te ulet, si dhe plotesueshme nga cdo operator qe eshte ne gjendje dhe do te realizoje nje furnizim si ai qe kerkon objekti i kontrates. Ky kriter është vendosur në mbështetje dhe të ligjit specifik, Ligji nr.10416, datë 07.04.2011 ” Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, Ligji 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 ”Për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”. Referuar bazës ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe bazuar në aktin nënligjor normativ të nxjerrë në bazë të Ligjit 10416, ku në pikën II, “KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE”, gërma ”d” të VKM 523 përcaktohet se:”1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi”.*

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet sipas shtojces 5 sipas të dhënave në DST. (Katalogu te permbaje

karakteristikat teknike te çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor te gjykoje nese malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike te modelit te kuotuar do te krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST per perputhshmerine e tyre).(Pjesa e katalogut qe perfshin specifikimet teknike te jete e perkthyer).

**Argumentimi:** *Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë
2	<i>Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	3 Copë
3	<i>Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton ) .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik ( e vlefshme ), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruar me siper nuk janë të angazhuara dhe te deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit."

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetit për transportin e mallit, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër transportin dhe shkarkimin për druret dhe shkurret dekorative sipas kërkesave të autoritetit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë marrin përsipër transportin dhe shkarkimin e mallit në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi për mosndarjen në lote:**

Procedura nuk ndahet në lote, pasi nuk është e nevojshme, procedura e hapur pa lote është bazuar në udhezimet si dhe në legjislacionin në fuqi.

Nuk është rasti kur kontrata ndahet në lote, nuk përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, nuk është rasi që vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurrohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

### Specifikimet teknike produktin:

#### **Drurë dekorative**

1. Të jenë me xogel (rrjetë) me buk dheu  $\phi \geq 40-80$  cm
2. Të jenë të trajtuar me trung të drejtë ,pa nyje dhe dëmtime të lëkurës
3. Të kenë kurorë të rregullt në formën e vet natyrale
4. Të kenë gjendje fitosanitare të shëndetshme dhe të mos kenë shenja sëmundjesh nga dëmtues kërpudhorë apo insekte
5. Cirkoferenca do të jetë sipas llojeve dekorative të pasqyruar në tabelën e mëposhtme

#### **-Shkurre Dekorative**

1. Të jenë me xogël (rrjetë) me buk dheu  $\phi \geq 30-40$  cm
2. Të jenë të trajtuar pa degëzime dhe dëmtime
3. Të kenë kurorë të rregullt në formë globe ose piramidale
4. Të kenë gjendje fitosanitare të shëndetshme dhe të mos kenë shenja sëmundjesh nga dëmtues kërpudhorë apo insekte
5. Cirkoferenca do të jetë sipas llojeve dekorative të pasqyruar në tabelën e mëposhtme

Nr	Emërtimi shqip	Emërtim i botanik	Specifikimet teknike				Të dhëna të tjera	Njësia matëse	Sasi
			Cirkoferene	Lartësi trungut	Lartësi i kurorës	Lartësi totale e bimesis e cm			
			cm	h /cm	h /cm				
A	<b>Drure dekorative</b>								

1	Frasher	Fraxinus ornus	12.-14	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	200
2	Lofate	Cercis siliquastrum	14-16	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	200
3	Carace	Celtis australia	14-16	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	150
4	Man	Morus Alba Pendula	14-16	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(ombrell)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	200
5	Shkoze	Carpinus betulus	14-16	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	200
6	Panje gjetherrapi	Acer platanoides	14-16	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	200
7	Verri	Alnus glutinosa	16-18	180--240	120-160	300-400	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	150
8	Rrap	Platanus orientalis	16-18	180--240	120-160	300-400	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit, me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 40$ cm	copë	300



9	Likuidamber	Liquidamber styraciflua	18-20	180--240	120-160	300-400	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	100
10	Fotinia	Photinia fraseri (red robin)	18-20	170-190	80-110	250-300	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	200
11	Liriodendron	Liriodendron tulipifera	20-25	220-250	130-150	350-400	Kurore në formë(konike)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	50
12	Sofora	Sophora japonica	20-25	200-250	100-150	300--400	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	100
13	Panje gjeterrapi	Acer platanoides	20-25	220-270	130-180	350-400	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	100
14	Liguster	Ligustrum vulgare	20-25	200-220	150-180	350-400	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 60$ cm	copë	110
15	Bli	Tilia Argentata	25-30	220-270	130-180	350-450	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 80$ cm	copë	500
16	Rrap	Platanus orientalis	25-30	220-270	130-180	350-450	Kurore në formë(ovale)karakteristike e llojit,me xogel (rrjetë) me bukë dheu $\geq 80$ cm	copë	100
<b>Shuma A Drurë dekorative</b>									<b>2860</b>
<b>B</b>	<b>Shkurre dekorative</b>								

1	Nandina	Nandina domestic a				120-130	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 30$ cm	copë	200
2	Oleander	Nerium Oleander				170-180	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 40$ cm	copë	500
3	Evonimus	Euonymus japonicas				30-40	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 40$ cm	copë	200
4	Bush glob	Buxus micropyl la				40-60	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 40$ cm	copë	500
5	Fotinia	Photinia fraseri				60-70	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 40$ cm	copë	350
6	Tuja formë	Thuja aurea nana				90-100	Kurore në formën karakteristike të llojit, me xogel (rrjetë) ose buke dheu $\geq 40$ cm	copë	250
<b>Shuma B Shkurre dekorative</b>									<b>2000</b>

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

### **SHKULJA E DRURËVE**

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trungu i pemës.

Gjatë shkuljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura.

Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri.

Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulet.

### **TRANSPORTIMI I DRURËVE**

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pesha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinç. Me qëllim që gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.

Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e buka e dheut të shtrihet në pjesën e karrocërisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisat për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulet, transportohen e mbillen kur temperatura zbrit në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim.

Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Operatori ekonomik do të marrë për transportin e mallit deri në vendodhjen e Autoritetit kontraktor.

*Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".*